



SHKOLLA E MESME TEKNIKE

SHABAN SPAHIJA



SOLIDAR
SWITZERLAND
Swiss Labour Assistance SLA

2017



Syri i Vizionit

Ky publikim u mundësua në kuadër të projektit ProKarriera, të cilin organizata joqeveritare “Syri i vizionit” është duke e implementuar me mbështetjen financiare të Solidar Suisse. Projekti ka për qëllim fuqizimin e shërbimit të këshillimit në karrierë nëpër shkolla për të ndihmuar të rinjtë të përshtaten sa më mirë me tregun e punës.

SHKOLLA SOT:

Shkolla e mesme teknike “Shaban Spahija” është një shkollë e rëndësishme sot në komunën e Pejës. Nga ajo kanë dalë kuadro që vazhdimisht kanë luajtur një rol me rëndësi në zhvillimin e komunës. Shkolla është pjesëmarrëse në shumë programe, që e kanë shndërruar atë në një institucion të suksesshëm arsimor, me kuadër profesional dhe kapacitete të mira të zhvillimit.

Me objektin e ri të ndërtuar në lagjen Rrokaqielli, janë përmirësuar kushtet, është zvogëluar distanca e udhëtimit, që ka ndikuar në shtimin e numrit të nxënësve që ndjekin këtë shkollë.

Në vitin shkollor 2016/2017 shkolla ka 70 paralele në gjuhën shqipe dhe 6 në gjuhën boshnjake me 1210 nxënës.

Me përfundimin e shkollimit merret titulli “Punëtor i kualifikuar”.



DREJTIMET:

Shkolla ka këto drejtime: elektroteknikë, makineri, ndërtimtari dhe tekstil në gjuhën shqipe; elektroteknikë dhe makineri në boshnjakisht. Brenda këtyre drejtimeve zhvillohen 18 profile të ndryshme profesionale. Numri i planifikuar i paraleleve në këtë shkollë varet prej numrit të nxënësve të regjistruar, por oferta e shkollës është gjithnjë më e madhe, sesa ajo që realizohet.

Në shkollë është i mundur edhe shkollimi për të rritur, pa shkëputje nga puna (me korrespondencë) në të gjitha drejtimitet.

HISTORIK:

Shkolla është hapur në vitin 1972. Më parë disa nga drejtimitet që u hapën janë mbajtur në Shkollën e Ekonomisë, kurse disa tjera në Shkollën e Artit.

Në një periudhë të gjatë shkolla ka qenë e shpërndarë në objekte të ndryshme, por pjesa më e madhe ka qenë e vendosur në Objektin B, shkolla që ndodhet në lagjen Kristal dhe që për një kohë të gjatë ka qenë objekti kryesor. Ndërsa tash pjesa më e madhe është e përqendruar në objektin e ri të ndërtuar nga MASHT në vitin 2014, ku ndjekin mësimin klasat 10 dhe 11, pasi klasa 12 ende vazhdon tek objekti i vjetër.

KAPACITETET:

Shkolla është e shpërndarë në tri objekte shkollore, që së bashku përbëjnë sipërfaqe të tërësishme shkollore prej 6500 metra katrore, hapësirë brendshme dhe oborri. Objekti i ri ka tre kate dhe është i përshtatshëm për mbajtjen e mësimit. Dy objektet tjera janë shkolla e vjetër (Objekti B) në Kristal dhe objekti i Zdrukthëtarisë prapa Burgut të Pejës, ku ndodhet edhe punëtorja e ndërtimtarisë. Këto objekte janë më të vjetra, por në dy dekadat e fundit kohë pas kohë janë bërë investime në to.

Shkolla ka këto kabinete: elektronikë, elektro-teknikë, informatikë, ujësjellës dhe kanalizimit, ngrohjes dhe klimatizimit, fizikës, si dhe punëtoritë e rrobaqepësisë, zdrukthëtarisë, autongjyrosjes, automekanikës dhe ndërtimtarisë, në të cilat kryejnë një pjesë të praktikës nxënësit e kësaj shkolle. Shkolla ka edhe palestrën e sportit dhe dy fusha të hapura. Pjesa tjetër e praktikës kryhet në institucione shtetërore dhe biznese private.



PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Në Shkollën Teknike deri tani janë zhvilluar shumë projekte të cilat kanë sjellë investime të fuqishme, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së shkollës dhe profesionalizimin e stafit. Investimet më të mëdha i ka bërë Qeveria Gjermane përmes organizatës GIZ (ish GTZ) që arrijnë vlerën mbi 3 milionë euro, me të cilat është bërë ndërtimi i punëtorive të shkollës për automekanikë, autongjyrosje, autollamarinist, metalpunues dhe zdrukthëtari dhe ajo ka bërë edhe trajnimin e mësimeve të mëdha. Disa kabinete tjera, përkatësisht në disa raste mjete dhe vegla pune, janë dhuruar nga organizata zvicerane Swisscontact: punëtoritë e rrobaqepësisë, automekanikës, ujësjellësit dhe kanalizimit, elektronikës. Shkolla është e përfshirë në projektet e avancuara mësimore si me IEME, UNDP, Bankën Botërore, etj. Shkolla bashkëpunon me një shkollë në Bursa të Turqisë, që edhe ka ndihmuar në donacione, shkëmbime profesionale dhe vizita. Renovimet këtë vit janë kryer edhe në objektin e vjetër me dyert dhe dritaret, dhe me planifikime për dyshemënë, çatinë dhe nxemjen qendrore.



PSE TË REGJISTROHEM NË KËTË SHKOLLË?

Shkolla Teknike krijon kuadro që gjinden shumë mirë në tregun e punës. Drejtimet e saj garantojnë punësim të lehtë, pasi janë profesione për të cilat ka nevojë në rajonin tonë dhe në çdo kohë garantojnë mundësi punësimi.

Shkolla ka kabinate ku zhvillohet punë praktike dhe nxënësit në përfundim të shkollimit arrijnë aftësi të mjaftueshme për t'u angazhuar në punë, apo me zhvillim të mëtejshëm të hapin vet biznesin e vet.

Me diplomat e shkollës teknike gjen mundësi punësimi edhe në tregun evropian, pasi drejtimet e Teknikës njihen dhe janë gjithmonë të kërkuara.

SHMT mbledh një numër të madh nxënësish mbi 1200 dhe kështu do të jeni pjesë e një komuniteti të madh dhe të angazhuar.



TREGU I PUNËS

Për të diplomuarit në drejtimet e shkollës së mesme teknike tregu i punës ka mundësi të shumta, kryesisht në sektorin privat, por edhe në ndërmarrje publike, institucione dhe me mundësinë që me kualifikimet shtesë të fillojnë edhe vet biznesin privat. Pjesa më e madhe e tyre këtë e arrijnë edhe pa pasur nevojë për kualifikime shtesë.

Rajoni i Pejës ka humbur fabrikat e mëdha që kanë funksionuar si ndërmarrje publike deri në vitet '90, por ka dhjetëra kompani dhe qindra firma të vogla në të cilat mund të gjeni mundësi të praktikoni shkathtësitë e juaja. Sektori privat i zhvilluar që ofron shërbime, për punëtorët e kualifikuar të elektroteknikës, makinerisë, ndërtimtarisë dhe rrobaqepësisë mund të ofrojë mundësi të mjaftueshme pune.

Ritmi i lartë i pandalur i ndërtimeve dhe zgjerimi i qyteteve ka shtuar nevojën për më shumë punëtorë në ndërtimtari, arkitektë, elektrikistë, metalpunues, instalues uji, kanalizimi, ngrohje dhe kanalizimeve, etj., ndërsa përdorimi gjithnjë e më shumë i teknologjisë, kërkon punëtorë të kualifikuar në informatikë, komunikim, makineri dhe transport. Në tregun evropian të punës ka mjaft kërkesë edhe për saldator dhe metalpunues, që janë edhe profesione profitabile, kurse në tregun vendor ka rritje të prodhimit në rrobaqepësi dhe zdrukthëtari.

Në përgjithësi tregu është i hapur me mundësi punësimi dhe vetëpunësimi për pothuaj të gjitha profilet e shkollave teknike, ndërsa shkalla e punësimit të të diplomuarve në këto shkolla është e lartë.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Informatikë

Shkollimi për “Informatikë”, niveli I dhe II u referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e teknologjisë së informacionit që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo, informaticieni i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që merren me ofrimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit e po ashtu edhe në dyqane që shesin kompjuterë dhe pajisjet periferike të tyre, ose mund të vetëpunësohet si ofrues shërbimesh nga lëmi i teknologjisë së informacionit sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Telekomunikacion

Shkollimi për “Telekomunikacion”, niveli I dhe II u referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e telekomunikacionit që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës, si shtëpitë radio-televizive, produktionet private të audio dhe videoprodukteve. Nisur nga kjo, tekniku i telekomunikacionit i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që japin shërbime të telekomunikimeve, ose mund të vetëpunësohet si instalues dhe mirëmbajtës ambulant (shëtitës), në këtë sektor, sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe aty pastaj mund të punësojë edhe persona të tjerë.

Komunikime audio dhe video

Shkollimi për “Komunikime audio dhe video”, niveli I dhe II, u referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e komunikimeve audio dhe video që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës, si shtëpitë radio-televizive, produksionet private të audio dhe video produkteve. Nisur nga kjo nxënësi për Komunikime audio dhe video i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që japin shërbime që kanë të bëjnë me komunikimet audio dhe video, ose mund të vetëpunësohet si mirëmbajtës ambulant (shëtitës) i teknikës audio dhe video. Me kualifikime të mëtjetshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Elektroteknikë

Shkollimi për Elektroteknikë, Energjetikë niveli I dhe II, i referohet punimeve elektrike në sektorin e ndërtimeve. Nisur nga kjo, tekniku i energjetikës i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që kryejnë ndërtime apo instalime elektrike. Ata mund të punësohen në ndërmarrje ku bëhen instalimet elektrike dhe ndriçim elektrik, në kompanitë që merren me gjenerimin dhe bartjen e energjisë elektrike, në industrinë prodhuese, në kompanitë që merren me hulumtime dhe zhvillim, në shërbime publike e tjera. Me kualifikime të mëtjetshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ata mund të krijojnë biznesin e tyre në këtë sektor dhe të punësojnë edhe persona të tjerë.

Metalpunuesi

Metalpunuesi kryen punime dhe zëvendësime të tërësive ose pjesëve të tërësisë që kanë të bëjnë me përpunimin e metaleve me deformim plastik, me gdhendje dhe me saldim. Ai mund të punësohet në kompani për përpunim të metaleve, në punëtori për përpunim të metaleve, apo të vetëpunësohet duke hapur punëtori të veten.

Instaluesi elektrik

Instaluesi elektrik i shkallës I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që kryejnë ndërtime apo instalime elektrike, ose të vetëpunësohen si instalues elektrik ambulant në këtë sektor, sipas kërkesave të klientëve. Më kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Ndërtimtar

Shkollimi për “Ndërtimtar”, niveli I dhe II, u referohet punëve në firma ndërtimore që merren me ofrimin e punimeve të ndërtimit, të tilla si punimet e muratimit, të betonimit, punimin e skeletit nga armatura, të suvatimit, ndërtimin e kulmeve dhe mbulimin e tyre etj., që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo nxënësi për Ndërtimtar i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që realizojnë ndërtimin e objekteve të ndryshme publike e private. Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Saldator

Shkollimi për “Saldator”, nivelet I dhe II, i referohet punimeve që kryhen me anë të saldimeve të llojeve të ndryshme, sektorë të ndryshëm të ekonomisë, punime që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e punës së Kosovës. Nisur nga kjo, saldatori i niveleve I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që kryejnë punime të saldimit ose mund të vetëpunësohet si saldator ambulant, në këtë sektor, duke punuar sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Dirigjimi Kompjuterik i Makinave- CNC

Shkollimi i referohet punimeve që kryhen në biron e teknologjisë së përpunimit dhe konstruktimit duke përdorur kompjuterët me CAM softvera bashkëkohor për programimin e makinave me dirigjim kompjuterik (makinat CNC), në industrinë metalpërpunuese dhe përpunimin e drurit, punime që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e punës së Kosovës. Nisur nga kjo, operatori në Makina me Dirigjim Kompjuterik (makinat CNC) I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që kryejnë punime në MDK (CNC) mund të vetëpunësohet si operator i MDK , në këtë sektor, duke punuar sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtjeshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit

Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit kryen punime dhe zëvendësime të tërësive ose pjesëve të tërësisë që kanë të bëjnë me instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ai mund të punësohet në kompani për instalime të ujësjellësit dhe kanalizimit, në institucione ku kanë nevojë për mirëmbajtje të ujësjellësit, kanalizimit dhe nyjave sanitare apo të vetëpunësohet duke punuar si i pavarur.

Instaluesi i ngrohjes dhe klimatizimit

Instaluesi i ngrohjes dhe klimatizimit kryen punime dhe zëvendësime të tërësive ose pjesëve të tërësisë që kanë të bëjnë me instalimet e ngrohjes dhe klimatizimit. Ai mund të punësohet në kompani për instalime të ngrohjes dhe klimatizimit, në institucione ku kanë nevojë për mirëmbajtje të ngrohjes, klimatizimit dhe nyjave sanitare apo të vetëpunësohet duke punuar si i pavarur.

Arkitekturë

Shkollimi për “Arkitekturë” u referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e punimeve të ndërtimit, zdrukthëtarisë, agjustarisë, hortikulturës (lulishteve), enteriereve, apo punëve në muze dhe galeri arti, apo në byro projektuese në sektorin e ndërtimtarisë, që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo nxënësi për Arkitekturë i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që japin shërbime që kanë të bëjnë me projektimin e ndërtesave, mobiljeve, lulishteve si dhe ndërtimin e objekteve të ndryshme. Me kualifikime të mëtjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Gjeodezi

Shkollimi për “Gjeodezi”, u referohet punëve në ndërmarrjet apo institucionet që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e gjeodezisë që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo, ai mund të punësohet në firma apo institucione që merren me gjeodezi dhe aty ku gjeodezia e gjen zbatimin e saj. Me kualifikime të mëtjme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Transport rrugor

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit në këtë profil, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale lidhur me transportin rrugor të njerëzve, mallrave, shenjat e trafikut, etj. Mund të punësohet në kompani të transportit rrugor të udhëtarëve, mallrave, garazhe, kontrole teknike të automjeteve, trafikun urban dhe ndërkombëtar, polici etj. Në institucione ku kanë nevojë për organizim të transportit, apo të vetëpunësohet duke punuar si i pavarur.

Zdrukthëtari

Shkollimi për “Zdrukthëtar” u referohet prodhimit të produkteve të zdrukthëtarisë të të gjitha llojeve. Arsimimi në këtë profil ofron kualifikim profesional për integrim në tregun e punës, si dhe vazhdimin në nivele më të larta. Nxënësi merr një certifikatë të përgatitjes profesionale të nivelit të punëtorit të kualifikuar dhe mundësi kalimi në studime universitare.

Automekaniku

Riparuesi dhe mirëmbajtësi i automjeteve bën kontrollin dhe diagnostikimin e automjeteve për të lokalizuar defektet, riparimin si dhe shërbime të ndryshme në sistemet dhe elementët mekanik, elektrik, elektronik, hidraulik të tyre. Ai mund të punësohet në kompani automjesh, në reparte autoservisi, në shoqëritransporti dhe tregtare që kanë reparte të shërbimit dhe riparimit të automjeteve, në qendra të kontrollit teknik të automjeteve apo të vetëpunësohet.

Rrobaqepësi

Profili i rrobaqepësisë përbëhet prej klasës X-të deri në të XII-të, me mbarimin e së cilës nxënësit marrin titullin e punëtorit, ndërsa kur vijojnë edhe klasën XIII-të fitojnë titullin punëtor i kualifikuar i rrobaqepësisë. Në këtë profil mësimor përfshihen të gjitha kategoritë e rrobave si funde, pantallona, fustane, jelekë, bluza, këmbisha, jakat e llojeve të ndryshme, xhepat, mansheta, gjithçka në shërbim të tregut dhe klientit. Nxënësit kryesisht bëhen të pavarur sa i përket estetikës së veshjes duke mësuar për përzgjedhjen e materialit kryesor dhe ndihmës, pastaj bënë edhe balancimin e ngjyrave që i përshtaten kohës klimatike, njëherit bazohet edhe në ndërtimin e trupit të klientit dhe ngjyrës së lëkurës së tij. Pas diplomimit të shkollës nxënësit bëhen të pavarur dhe kanë mundësi të punësohen në fabrika të mesme apo të vogla, gjithashtu kanë mundësi që të hapin punëtoritë e tyre private.

Lëmi	Profili
Elektro- teknikë	Informatikë
	Telekomunikacion
	Komunikime audio-vizo
	Instalues elektrik
	Elektroteknikë
Makineri	Automekanik
	Metalpunues
	Instalues uji e kanalizimi
	Instalues ngrohjes dhe klimatizimit
	Transport rrugor
	Makinat CNC
	Autongjyrosës
	Saldator
Ndërtimtari	Ndërtimtari
	Arkitekturë
	Zdrukhëtari
	Gjeodezi
Tekstil	Rrobaqepësi

Për më shumë informata lidhur me kriteret dhe afatet e regjistrimit, shikoni konkurset e pranimit të nxënësve në shkolla, ose informohuni direkt në shkollë.



Kontaktet

Adresa e shkollës: Rr. Esad Mekuli
Telefoni i shkollës: 039/421222

Drejtori: Arben Gjokolli
tel. 049 766 707

e-mail: nebra592011@hotmail.com
Sekretar: Teuta Billalli